

VENDIM
Nr. 716, datë 1.12.2017

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË KRYERJES SË KONTROLLIT TË
VEPRIMTARISË SË NDËRMARRJES SOCIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 22, të ligjit nr. 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale, nëpërmjet inspektoratit përgjegjës për çështjet sociale, ushtron kontrolle, me qëllim që të sigurojë respektimin e legjislacionit për ndërmarrjet sociale nga subjektet zbatuese.

2. Inspektorati përgjegjës për çështjet sociale, në varësi të fushës së veprimtarisë së ndërmarrjeve sociale, siguron bashkëpunim dhe koordinon punën e tij me Inspektoratin Qendror, ministritë dhe institucionet në varësi të tyre dhe inspektoratet e tjera shtetërore, në përputhje me ligjin për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

3. Bashkëpunimi me institucionet e tjera, sipas pikës 2 të këtij vendimi, realizohet nëpërmjet hartimit të programeve të punës për organizimin e kontrolleve të përbashkëta, në varësi të fushës së veprimtarisë dhe problematikave të mundshme, si dhe nëpërmjet shkëmbimit të informacionit në rastet e konstatimit të shkeljeve të legjislacionit, që nuk mbulohen nga institucioni që kryen kontrollin.

4. Inspektorati përgjegjës për çështjet sociale ka përgjegjësinë:

- i) të kontrollojë dhe të verifikojë respektimin e kërkesave ligjore në fushën e çështjeve sociale;
- ii) të kontrollojë përmbushjen e kriterëve dhe të kushteve që plotësojnë subjektet publike dhe jopublike, që ushtrojnë veprimtari në këtë fushë;
- iii) të kontrollojë plotësimin e standardeve të shërbimeve të ofruara nga ofruesit dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror;

iv) të kontrollojë përmbushjen e kriterëve dhe të kushteve sociale dhe ekonomike që plotësojnë organizatat jofitimprurëse, që ushtrojnë veprimtari sipas ligjit për ndërmarrjet sociale.

5. Inspektorati përgjegjës për çështjet sociale, në përputhje me ligjin për shërbimet e kujdesit shoqëror, mbikëqyr dhe kontrollon në formë elektronike nëpërmjet portalit “e-Inspektimi”, përmbushjen e kriterëve sociale dhe ekonomike, në përputhje me përcaktimet e ligjit për ndërmarrjet sociale.

6. Inspektori, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij inspektuese, identifikohet me kartën e inspektorit të lëshuar nga Inspektorati Qendror dhe kryen inspektime me listëverifikime dhe dokumentacion online.

7. Për shkelje të dispozitave të legjislacionit të ndërmarrjeve sociale, inspektorati përgjegjës për çështjet sociale vendos gjobë në masën e përcaktuar në nenin 23 të ligjit nr. 65/2016. Në rast të parregullsive të rëndësishme ose të përsëritura, inspektorati njofton me shkrim dhe pa vonesë Inspektoratin Qendror, i cili ia përcjell menjëherë autoritetit përgjegjës.

8. Të gjitha të ardhurat nga gjobat e vendosura derdhen tërësisht në buxhetin e shtetit.

9. Përfaqësuesit e ndërmarrjeve sociale kanë të drejtë të informohen për kryerjen e inspektimit nëpërmjet njoftimit paraprak të autorizimit të subjektit të inspektimit, jo më vonë se 3 (tri) ditë përpara fillimit të veprimtarive të inspektimit, përveç rasteve të inspektimit jashtë programit dhe inspektimit rastësor.

10. Inspektimi jashtë programit kryhet kur ndërmarrja sociale nuk ka paraqitur raporte periodike

brenda afatit të caktuar, nuk ka paraqitur informacion të plotë, kur ka dyshime për vërtetësinë e informacionit ose të një denoncimi të marrë nga të tretët.

11. Përfaqësuesit e ndërmarrjeve sociale kanë detyrimin të sigurojnë të gjitha të dhënat e nevojshme që lidhen me zbatimin e legjisllacionit të ndërmarrjeve sociale.

12. Për të gjitha aspektet e inspektimit, të cilat nuk janë rregulluar shprehimisht në këtë vendim, të zbatohen parimet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

13. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe inspektorati përgjegjës për çështjet sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi